



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 210, Datë 15.12.2020

MBI

**MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGIJA D.O.O VETERNIK” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “ç”, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “d”, nenit 5, pika 1, gërma “d” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 19 pika 1, gërma “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 15.12.2020, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “ENERGIJA D.O.O VETERNIK” sh.p.k., si dhe relacionin nr. 132/1 Prot, datë 10.12.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, për mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “ENERGIJA D.O.O VETERNIK” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

**Konstatohet se:**

- Shoqëria “ENERGIJA D.O.O VETERNIK” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1086/2 Prot., datë 26.10.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Në datën 06.01.2015 është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k), konform Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.
- Aplikimi i shoqërisë “ENERGIJA D.O.O VETERNIK” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”). Plotësuar tërësisht.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”). Plotësuar pjesërisht.

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”). Plotësuar pjesërisht.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin furnizimit të energjisë elektrike (neni 9 pika 4.7 gërmat “a”, “b”, “c”, “e”, “d”, “f”). Plotësuar pjesërisht.
- Të dhëna për klientët dhe energjinë e furnizuar (neni 9, pika 4.7, gërma “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i”). Plotësuar pjesërisht.
- Në mbledhjen e bordit të ERE-s te dates 02.12.2020, në vijim të relatimit të Relacionit nr. 125/2 Prot., date 01.12.2020, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Energija D.O.O Veternik” në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike” dhe Relacionit nr. 125/3 Prot., datë 01.12.2020, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Energija D.O.O Veternik” në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, bordi gjykoqi që vendimi i fillimit të procedurave për këto aplikime të shtyhej, në mënyrë që shoqëria të kryejë diferencën e pagesës së aplikimit për licencim në veprimtarinë e tregtimit dhe furnizimit të energjisë elektrike, duke qenë se rezultoi se kjo pagesë nuk ishte kryer e plotë.
- Në vijim të sa me sipër ERE iu drejtua shoqërisë me e-mailin e datës 02.12.2020, protokolluar në po të njëjtën datë me nr. 1086/3 Prot., duke i bërë me dije se në kuptim të nenit 8, pika 2, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, Aplikuesi do të kryej pagesën e aplikimit në momentin e paraqitjes së aplikimit siç përcaktohet në aneksin A të saj. Po në kuptim të këtij neni një aplikim duhet të jetë i shoqëruar me pagesën e aplikimit e më tej të vijohet me trajtimin e tij. Po ashtu iu kërkua shoqërisë kryerja e pagesave respektive në llogarinë e ERE-s me qëllim trajtimin e kërkesës për licencim në mbledhjen më të afërt të bordit të ERE-s, dhe iu shpjegua se kryerja e pagesës së aplikimit përbën një nga kushtet thelbësore për fillimin e një procedure.
- Shoqërisë i janë dhënë edhe më herët sqarimet përkatëse për aplikimin e ri për licencim me e-mailin e datës 26.10.2020.
- Nga rakordimi me Drejtorinë e Financës dhe IT nuk rezulton që deri më sot, shoqëria të ketë kryer pagesat respektive si më sipër kërkuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

### Vendosi :

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ENERGIJA D.O.O VETERNIK” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë, për një afat 5 vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

**KRYETARI I ERE**

**Petrit AHMETI**